



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 270 Prot.

Tiranë, më 10 /02/2017

VENDIM

Nr. 23 ,datë 10/2 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1513 Prot., datë 22.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkisë Pogradec me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtarë".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresat e datës 13.10.2016 ka kërkuar nga Bashkia Pogradec t'i vihen në dispozicion informacioni si më poshtë:

Në lidhje me shkresën nr. 200/16 Prot:

1. Cilat janë shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;
2. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
3. Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
4. Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
5. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.

Në lidhje me shkresën nr. 201/16 Prot:

1. Kopje të strukturës organizative;
2. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit;
3. Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë;

4. *Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit.*

*Në lidhje me shkresën nr. 202/16 Prot:*

1. *Kopje të planeve strategjike të punës;*
2. *Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016;*
3. *Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016;*
4. *Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit;*
5. *Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik;*
6. *Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;*
7. *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
8. *Cilat janë mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

*Në lidhje me shkresën nr. 203/16 Prot:*

1. *Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;*
2. *Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj.*

Autoriteti Publik/Bashkia Pogradec, me anë të komunikimit elektronik, ka kërkuar nga Qendra "Res Publica" saktësimin e mënyrës së kthimit të përgjigjes mbi informacionin e kërkuar. Edhe pas sqarimit nga ana e kërkuarit, Bashkia Pogradec nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit në lidhje me shkresat e datës 13.10.2016, ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim.

Në këto kushte ankuesi Qendra "Res Publica" kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Çdo autoritet publik në kuptim të nenit 7, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duhet të ketë publik në programin e transparencës të gjithë informacionin e kërkuar, i cili përfshihet në kategoritë e informacionit, që vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik/Bashkisë Pogradec, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 1513 Prot., datë 22.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Bashkia Pogradec, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Bashkia Pogradec, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (shkresa nr. 200/16 Prot., nr. 201/16 Prot., nr. 202/16 Prot., nr. 203/16 Prot datë 13.10.2016), brenda datës 10. 2 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 10. 2 .2017.

